Me konfigurimin WAP 1.x , një opcion e Segmentimit dhe ribashkimit (SAR) të mekanizmit [WAP-224] lejon një grumbull të madh të transaksioneve të segmentuar në nivelin WTP nga dërguesi dhe të ribashkuara nga pranuesi. SAR përdoret posaçërisht në rastet kur madhësia e një transaksionit (p.sh., tërheqjen e një mesazhi multimediai prej 50- KB) tejkalon Maksimumin e Njisis së Transmetimit WTP (Maximum Transmission Unit-MTU). Në kontekstin e MMS, SAR është përdorur për transaksionet duke përfshirë dërgimin dhe tërheqjen e mesazheve të mëdha. Duhet të dini se, në konfiguracion WAP 1.x, SAR është opsional dhe në qoftë se ajo nuk është e mbështetur në nivelin WTP, atëherë segmentimit dhe ribashkimi mund të mbështeten në një shtresë bazë (p.sh., [RFC-791] për IP, [3GPP-23,040] për SMS, etj.) [7]

4. METODOLOGJIA

Për hulumtimin e kësaj teze, është përdorur metoda sasiore e studimit të rastit të komparacionit, si metodologjia më e përshtatshme e ndërlidhjes mes NGN-it dhe telefonisë mobile. Grumbullimin i informacioneve është përdorur sipas matjeve dhe mirmbajtjes ditore të personelit NGN dhe të menagjimit brenda rrjetit të PTK-së.

Hapat metodologjikë, që janë ndërmarrur për t'i përgjigjur çdo pyetje ose për të testuar çdo hipotezë ose problem të formuluar në këtë studim janë të mbledhura me metodën empirike së të dhënave, intervistave me puntorë, analizën e të dhënave, brenda stafit punues të NGN-it dhe Vala në PTK ShA.

Të dhënat primare: janë aplikuar duke përdorur metodën empirike, nga praktika 1 mujore në PTK Ferizaj dhe vëzhgimi brenda stafit, informatorë kyçë siq janë ditaret e punës, diskutimet grupor, bisedat e strukturuar me njerzë të mirmbajtjes në Paisje të qasjes dhe transmetim.

Të dhëna per kete hulumtim jane mledhur në komplet të dhënat e papërpunuara te prodhuesit Allkatel, librat e ndryshem dhe interneti.

Metodologjia e hulumtimeve tona është e orientuar në kërkimin e përgjigjeve në pyetje dhe çështjet e parashtruara që në fillim të tezës së hulumtimit tonë dhe një kërkim sistematik, i precizuar për te njohur konceptet e lidhjeve mes rrjetetve të telefonise fikse dhe mobile si dhe zhvillimet në komunikime të reja, interpretimin e njohurive nëpërmjet shkathtësive hulumtuese në literature, njorurive të së kaluarës, të sotmës dhe të sfidave të së ardhmes teknologjike të afërt.

5. RASTI STUDIMIT

Në këtë tezë jami orientuar në metodologjine komparative të dy rrjeteve të cilat e dominojnë boshtin kurrizore të komunikimeve në Kosovë dhe historise se zhvillimit teknologjik të cilat në themel kanë filozofinë e ngjashme të funksionimit si qendrat komutuese të cilat funksionojnë në principe të njejta që nga sistemet e vjetra PSTN elektromekanike, krosbar, gjysëmletrike, elektrike dhe deri te sistemet e reja digjitale NGN të telefonisë fikse, e që karakterizohen me këto parametra si:

- Komutimi i lidhjeve në sistemet PSTN ka qenë me kumutim të qarqeve,
- Lidhja e abonenteve të rrjetit fiks (PSTN) deri në fillshpërndasë ka qenë i lidhur me fije të bakrit,
- Telefoni fiks është paisje e bazuar vetëm në dhënjen e shërbimëve të zërit,
- Bartja e sinjalit në fijet e bakrit ishte me sinjal analog,
- Mirmbajtja ishte shumë e vështirë,
- Krijimi i lidhjes realizohej nëpërmjet sistemit sinjalizues MFC (Multifrequent Contoll)

Me ndryshimet teknologjike dhe me migrimet në sitimin digjital NGN kemi këto shërbime:

- Komutimi i lidhjeve në sistemet NGN bëhet me kumutimin e paketeve,
- Kyqja e abonentit bëhet në pisaje të qasjes,
- Bazë për bartjen e shërbimeve janë IP protokolet,
- Lidhja e abonenteve të rrjetit fiks (NGN) bëhet nëpërmjet fijeve të bakrit ose kabllit optik,
- Telefoni fiks e ka mundësin afishimit të abonentit që thirrë dhe se përveq shërbimit të zërit këtu kemi edhe shërbimin e internetit dhe sinjalit televiziv,
- Me përdorimin e modemeve të ndryshme, kemi mundësin e transmetimit të të dhënave të shpejtesive të larta, shërbimet e internetit dhe shërbimet e televizionit IPTV ,
- Sinjalizimi me rastin e krijimit të lidhjeve nga abonenti A drejt abonentit B realizohet nëpërmjet protokoleve ATM dhe SDH,
- Evitohet mundësia afishimit të numrit të abonentit i cili thirre dhe atij që pranon thirrjen,

Sfidat dhe kufizimet e lartepërmendura teknologjike, i eviton tani telefonia mobile me shërbimet vijuese dhe zgjidhjet në vijim si :

- Kyqja pa tela në qendrën e komutimit të telefonisë mobile,
- Mundësia e afishimit të numrit të parapaguesve thirres,
- Bartja e të dhënave me shpejtesi të mëdha deri në 100 MBps për abonentet në lëvizje me shpejtesi 80 km/ore dhe 1 GBps për abonentet statik, në gjeneratën e katërt të telefonisë mobile,
- Bartja e shërbimeve SMS (shërbimi i mesazheve të shkurtera), MMS (Shërbimet Multimediale), CH (Mbajtja e lidhjes), CB (Bllokimi i lidhjes), realizimi i lidhjes konferenciale mes disa abonenteve, transferimi i lidhjes,
- Transmetimi dhe pranimi i sinjalit televiziv HD,

- Pecaktimi i pozicionimit te stacionit mobil (abonentit) me saktesi shum të lartë,
- Mundesia e romingut, ose thënë ndryshe komunikimi jashtë shtetit,
- Mbikqyrja e sistemeve nga një qendër e përbashket, etj

Krejt në fundë mundë të themi se ndërlidhja e këtyre rrjetëve për momentin është si proces i tranzicionit nga telefonia fikse drjet një të ardhëme complete pa tela. Ndërlidhja mes tyre bëhet me sistemet e transmetimit SDH (Rrjetit qëndrorë) thënë ndryshe kabllit optik, kurse në të kaluarën është realizuar nëpërmjet radio lidhjeve. Pra në kuptimin funksional të dy rrjetet janë autonome dhe të përbashkët kanë vetëm transmetimin.

5.1 Arkitektura e organizimit të rrjetit të telefonisë celulare

5.1.1 Brezi frekuencor i sistemit GSM , DCS dhe UMTS

Shkurtesa për sistemet GSM rrjedhin nga fjalët angleze Glogal System for Mobile Comunikations. Rrjeti Numerik Celular Radio Mobil PLMN me transmetim në brezin radio numerik shfrytëzon brezin frekuencave mes 880 MHz- 915 MHz të brezit të sipërm dhe 925 MHz-960 MHz brezi i poshtëm i frekuencave. Sistemet e rrjetave digjitale GSM 900 janë të projektuara për mbulesa të zonave të mëdha rurale duke përfshirë rrezën maksimal të celulës deri në 35 km.

Ndryshimet thelbësore në mes të rrjetave GSM dhe DCS janë në frekuencën e punës, gjerësinë e brezave dhe mes brezave, hapësira duplekse (si p.sh. në mes dy kanaleve fqinje të lidhjes rënëse dhe asaj rritëse) dhe numri i kanaleve bartëse radio (RFC).

Ndërsa rrjeti tjetër DCS 1800 (Digital Cellular Syste) me brez 1710 MHz-1785 MHz për brezin e sipërm dhe 1805 MHz -1880 MHz për brezin e poshtëm, të ashtuquajtur sistemi celular numerik i cili punon në brezin frekuencave 1800 MHz , i projektuar për mbulim të qelizave me dendësi të madhe të abonentëve për rreze deri në 8 km. Këto rrjeta janë të pajtueshme dhe abonentët mund të komunikojn duke pasur lidhje me roming edhe për rrjeta të tjera [11].




Figure 9. Shpërndarja e brezit dhe numri i radio kanaleve për sistemet GSM dhe DCS [11]

Për zona me popullsi të dendur të cilat zakonisht shpërndahen nëpër qytete, fuqia e transmetimit ose siç thuhet rrezja i qelizës duhet të jetë sa më i vogël, dhe distanca e sigurisë do të jetë më e vogël. Sistemi PCM30 ka një link me 32 kanale, ndërsa në brezin e frekuencave prej 35 MHz janë të vendosur 174 radio kanale me gjerësi të brezit frekuencave 200 KHz, pasi që secili kanal përbëhet nga 8 kanale tjera të shumfishuara me ndarje kohore TDMA (Time Division Multiple Access), vijmë në përfundim se një BTS do të ketë $174 \times 8 = 1392$ abonentë të mundshëm për rrjetin GSM dhe $374 \times 8 = 2992$ për rrjetin DCS të treguar si në fig.10.

Shërbimet mobile në fund të viteve 99 kanë kaluar shifrën 50% për shtete të caktuara.




Figure 10. Brezat e kushtuara UMTS [7]

Siç mund të shifet nga kërkesa për shërbime të llojllojshme, sëbashku me rritjen e kërkesave për shpejtësi të larta, ka shtruar nevojën për zgjedhjen e një brezi të ri për shërbimet e gjeneratës së

tretë. Frekuencat e tanishme 900 deri 1800 MHz, mund akoma të shërbejnë për shërbimet e zërit, por nuk mund në asnjë mënyrë të plotsojnë kërkesat për shërbimet e reja dhe për shërbimet e të dhënave në veçanti.

Për kalim nga gjenerata e dytë e radiosistemeve mobile në gjeneratën e tretë, duhet të egzistoj një strategji e mirëfilltë e cila më së miri është e dhënë në kapitujt vijues. Këtu është paraqitur pika fillestare prej nga do të fillojë migrimi për gjeneratat e ardhshme. Qëllimi i fundit është nevoja për përkrahje të shërbimeve radio me shpejtësi shumë të mëdha. Këto shërbime do të duhej të përfshinin të gjitha shërbimet GSM2+ MMS (shërbimet e rrjetave multimediale për aplikime patela) [7].

Qëllimi i zhvillimeve dhe migrimit nga sistemet e gjeneratës së dytë në ato të tretën është të ruhen investimet e gjeneratës së dytë me ringritje evolutive të GSM duke vërtetuar rotingun e kalimit në gjeneratën e tretë dhe handoverin në pajtueshmëri me sistemet.

Struktura ndërkombëtare e Rrjetave Publike Vendore Radio Mobile shënohet si PLMN dhe merret nga shkronjat e para të Public Land Mobile Network .

Termi GSM është standardi për sistemet globale të komunikimeve mobile dhe si i tillë është i rregulluar me marrveshje të ETSI (Europen Telecommunications Standards Institute). Në këtë grup punon Grupi Special për telefoni Mobile SMG (Special Mobile Groups) i cili është përgjegjës për standardet GSM. Rezultatet e këtij grupi i dedikohen rrjetave GSM 900 dhe DCS 1800 [11].

Pjesët përbërse të rrjeti GSM janë stacioni Mobil MS (Mobile Station), Identiteti i modulit të abonentit SIM (Subscriber Identifier Module), nënsistemi radio RSS (Radio subsystem), nënsistemi i stacioni bazë BSS (Base subsystem) i përbërë nga stacioni bazë i transkodimit BTS (Base Transceiver Station), Stacioni bazë i kontrollimit BSC (Base Station Controller), njësia e transkodimit dhe përshtatja e shpejtësive TRAU (Transcoding and rate adaption Unit).




Figure 11. Organizimi i rrjetit mobil GSM [7].

Stacioni bazë BS është grup i pajisjeve cili ndërlidhet përmes radio valëve Um deri në stacionin mobil MS. BS ka projekt modularë dhe përbëhet nga :

- BTS – Stacioni Bazë i Marrës-dhënësit (Base Tranceiver Station).
- BSC- Kontrolluesi i stacionit bazë (Base Station Controller).
- TRAU- Njësia për transkodim dhe adoptim të shpejtësive (Transcoding and Rate Adaption Unit).

BSC-ja është një qendër e kontrollimit në të cilin janë të lidhur disa BTS-a. Ndërlidhja ndërmjet BSC dhe BTS-ëve quhet ndërfaqja Abis. Unifikimi i pajisjeve hardwerike dhe softwerike si njësi të veçanta BSC, TRAU dhe BTS formojnë njësinë e cila quhet Sistemi i Stacioneve Bazë BSS (Base Station System). Gjatë punës së tyre dhe komunikimeve mes paisjeve vlen të theksohet rregulli se një BSC i një rrjeti kontrollues njëkohësisht e shërben vetëm një stacion të sistemit bazë [7].

5.1.2. Nënsistemi i rrjetit NSS (Network subsystem)

Pjesët përbërse të një nënsistemi komutues janë:

- MSC-Qendra Komutuese e Shërbimit Mobil (Mobile Services Switching Center).
- HLR-Regjistri i abonentëve vendëse (Home Lokation Register).
- VLR-Regjistri i abonentëve vizitorve (Visitor Location Register).
- AC-Qendra e Autentikimit (Authentication Center).
- EIR- Regjistri i identitetit të paisjeve (Equipment Identifikation Register).

Pajisjet shtesë të cilat komunikojnë me qendrën komutuese MSC dhe të cilat bëjnë pjesë në arçitekturën e GSM janë edhe:

- VMS- Sistemi postar i zërit (Voica Mail Sistem).
- SMSC-Qendra e shërbimit me mesazhe të shkurtëra (Short Mesage Service Center).
- IN –Rrjeti intelgjenët (Intelegent Network)

Shërbimi VMS dhe SMSC janë sisteme të cilat janë të lidhura me një ose më shumë qendra komutuese dhe kyqen në shërbim për rastet kur abonenti për ndonjë arsye nuk ka mundësi të përfundoj kërkesën. Me rastin e parë të mundshëm, pas rikthimit në rrjetë ai do të bëjë pranimin e mesazhit, zërit, faksit ose të dhënave të ndryshme.

Shërbimi intelgjentë IN është shërbim shtesë i instaluar në rrjetin GSM si platformë e veçantë. Kjo platformë është e lidhur me Shërbimin e Pikës së menagjimit SMP (Service Menagement Point), Pikën e Shërbimit të Kontrollit (Service Controll Point) dhe Pikën e Shërbimit të Komutimit SSP (Service Switching Point).

Pikat e shërbimit të komutimeve për shërbime inteligjente SSP shërbejnë për të njohur thirrjet e pranuar dhe më pas duke i drejtuar në SCP deri te abonenti tjetër.

Shtytësi Inteligent IP (Intelligent Propel) është një shërbim i cili shërben për detektimin e sinjalit dual dhe lidhet me SSP në raste të analizave të bisedave [11].

Në tërësi këto grupe lidhen në formën e dhënë sipas skemës dhe formojnë arkitekturën e rrjetit GSM me pjesët përbërëse të dhënë si në fig 12.

5.2. Zhvillimi i rrjetit mobil GSM dhe migrimi në gjeneratën e tretë 3G LTE

Shërbimet e para të quajtura TACS (Total Access Communication System)-Sistemi komunikues me Akses total, në vitet 90 –ta kan qenë në gjendje të ofroj shërbime të nevojshme abonentit potencial me terminal të madhësisë së papërshtatshme, peshë të madhe dhe kohzgjatje të vogël të baterisë.

Shërbimet TACS i kan dhënë formë të përgjithësuar sistemeve të ardhshme digjitale GSM që janë specifikuar nga ETSI, organizata e cila ka mandat të zhvilloj standardet Europjane të telekomunikimeve. Kërkesat e para të aplikimit të sisteme digjitale janë vërtetuar në fillim të viteve 1994, ndërsa rënja totale e atyre analoge ka filluar në vitin 1997. Siç u cek më sipër, shërbimet me të dhëna për sisteme mobile do të jenë shumë interesante dhe se këto zhvillime tani janë përherëshme. Llojlojshmëria e parashikimeve të shërbimeve, sëbashku me nevojat e pastra për burime të reja spektrale, rëndonë mbi trupat rregullatorë, operatorët dhe prodhuesit të cilët kujdesen për kalim në “gjeneratën e tretë” të zhvillimeve.

Faktorët vendimtarë, për përcaktim të nevojave tjera të komunikimeve mobile, duke respektuar vetitë eksistuese përfshijnë:

- Kërkesat e reja për shërbime të cilat nuk kan qenë të përfshira në gjeneratën e dytë të zhvillimeve të GSM.
- Mundësia për breza të reja të kanaleve radio të cilat do të shfrytzojn operatorët eksistues dhe konkuruesit potencial të rinjë.

Kjo kërkesë e ndryshimeve nga sistemet e tanishme në ata të gjeneratës së ardhshme, me mundësi të shërbimeve shtesë është emruar UMTS (Universal Mobile Telecommunications System) Sistemet Universale i Telekomunikimeve Mobile.

Zhvillimi i sistemeve mobile për gjeneratën e tretë përfshinë edhe kërkesat e shtruar nga operatorët e rrjetave, abonentët potencial, provajderët e shërbimeve, prodhuesve dhe trupave rregullatorë.

Si pjesë e kërkesave gjenerale për lidhje në shërbimet pa tela, është shërbimi i internetit. Tregu i shërbimeve multimediale është rritë në mënyrë rapide që nga viti 2010, dhe kjo do të shërbej si

bazë e mirë për parashikim të vendosjes së terminaleve të reja, ose telefonisë inteligjente, e cila kapë sistemet celulare me Asistentin Personal Numerik dhe shërbimet multimediale.

Për zgjerime të ardhëshme ,abonentët kërkojnë:

- Lidhje pa tela të Internetit me Intranetin.
- Brezi i gjërë i shërbimeve të mundshme, duke përfshirë llojet e shërbimeve multimediale.
- Terminalët kompakt, me peshë të vogël dhe të përbalueshme për blerje.
- Operimi i thjeshtë me terminale.
- Strukturë të pranueshme dhe të hapur për tërë spektrin e mundëshëm të shërbimeve.

Siq është dhënë edhe në figure arkitektura e rrjetit UMTS është e ngjajshme me atë GSM. BSS është zëvendësuar me UTRAN e cila kërkon skjarime për funksionin bartës . UMSC është qendra komutuese e rrjetave UMTS.

Risit të cilat dallojnë nga rrjeti GSM dhe gjeneratës tretë UMTS shtrihen në pamëdyshje në adaptimin e radio interfejsit. E para nga të gjitha është rritja e shpejtësisë së biteve e cila me W-CDMA është 2 Mbit/s, pastaj rangu I gjërë I shërbimeve I cili do të ket mundësi të mbështes kërkesat për shërbime të të ardhëmës. Kjo paraqet një ndryshim thelbësor në krahasim me kanalin e zësrut në GSM për shpejtësi të kanalit 9.6 kbit/s për kanal të të dhënave. Gjithashtu infrastruktura e komutimit të qarqeve UMTS duhet të mundësoj bartjen, realizimin dhe shkëputjen e lidhjeve për shpejtësi të ndryshme për nivele të larta të kompleksitetit mbi 64 kbit/s të arkitekturës komutuese. Platforma transportuese e UMTS duhet të siguroj shërbime të komutimit për komutim qarqesh dhe pjesës IP. Përderisa në gjeneratën e dytë GPRS ishte I projektuar si shërbim shtesë për




Figure 12. Migracioni i sistemit komutues nga GSM në UMTS [7].

transport të zërit, në UMTS zëri dhe të dhënat janë pjesë integrale e arkitekturës së rrjeteve andaj është e qartë se duhet adoptuar teknologjin e transportit të optimalizuar për të dy shërbimet [2].

Për të mundur bartjen pa pengesa të zërit dhe të dhënave në të njëjtën kohë është e domosdoshme të bazohemi në zgjedhjen e protokoleve ATM. Kjo teknologji është me përdorim të gjërë në bartjen e informative nëpërmjet IP protokoleve për rrjeta të mëdha . duke falënderuar vetive shumë të mira të standardeve dhe protokoleve për drejtim të thirrjes, rutim, adresim, gjithashtu mundë të përfshinë edhe sinjalizimin, transportin dhe ritjen e aftësisë së rrjetit ndaras nga protokolet IP siq janë Etherneti, Etherneti shumë i shpejt, dhe Frame Relai. Kjo don të thotë se këto protokole mundë të punojnë në mjedise shumëprotokolshe dhe mbështet shërbime të shumëllojshme.

Në fig.13. është dhënë struktura e zhvillimit për parashikimin e sistemeve të gjeneratës së katërt duke përfshirë në tërësi rrjetat ekzistuese me teknologji të ndryshme të transporti dhe ndërfaqet të cilat i ndërlidhin. Pikat startuese të zhvillimit do të jenë operatorët mobil GSM dhe operatorët e rrjetit fiks (ATM, IP-Rrjetat, ISDN).




Figure 13. Skenari i kalimit nga gjeneratë e tretë në gjeneratën e katërt të sistemeve mobile radio [7]

Sistemet mobile radio të gjeneratës së tretë do të lidhen me lidhje në rrjeta radio RAN (Radio Access Network) dhe rrjetat private zyra e vogël/zyra në shtëpi SOHO (Small office/Home office). Këto rrjeta me lidhje radio janë të lidhura me rrjeta fikse si:

- Nëpërmjet ndërfaqes A dhe qendrës komutuese mobile MSC me komutim të shërbimeve të qarqeve;

Nëpërmjet ndërfaqeve Gb,GPRS (General Packet Radio Service) mbështetë nyjenë SGSN (Serving GPRS Support Node), dhe portën GPRS me mbështetje të nyjes GGSN (Gateway GPRS Support Node) për shërbime me orientime

Rrjetat fikse përfshijnë N-ISDN dhe rrjetat publike me komutim telefonik PSTN (Public Switching Telephone Networks) dhe rrjetat e internetit IN. Për transport në rrjetin backbone mund të funksionojnë nëpërmjet protokollit ATM [11].




Figure 14. Shërbimet për gjeneratën e tretë [11].

Shërbimet e përparuara janë shërbime multimediale MMS të cilat shkojnë paralel me zërin, videon, teksti i animuar dhe grafiqet si faqet web gjuha e caktuar hipertekst HTML (Hypertext Markup Language) dhe animacionet Java, animacionet grafike si rrjedhje në kohë reale përmes IP, dhe të dhënat e-mail për transmetimin e fajllave. Prandaj, tipi i trafikut me internet do të dominojnë multimediet. Në rastet e pranimeve dhe përcjelljeve të grupeve rrjedhëse të pavarura paralele të medimeve, janë të mundshme rrugë të pavarura të bartjes.

Kërkesat themelore në zhvillimin e GSM janë përkrahja multimediale, shpejtësitë e larta të bartjes të dhënave, mjediset shtëpiake virtuale, konfigurimi i softverit të mobilit, dhe romingu global. Qëllimet kryesore më tërheqëse për gjeneratën e ardhëshme të terminaleve mobile është asistenti numerik personal PDA (Personal Digital Assistans), laptopat pa tela, dhe radioteknologjia si UTRAN [1]..

5.3. Organizimi i ndërlidhjes së arkitekturës të rrjetit fiks dhe mobil të Kosovës

5.3.1 Ndërlidhja mes rrjetit fiks Next Generation Network (NGN) dhe mobil Vala të Kosovës

Organizimi i rrjetit NGN karakterizohet me pjesë përbërse siq janë rrjeti IP, sistemi transmetues optik, PDH dhe SDH. Në figurën e mëposhtme kemi të dhënë arkitekturën complete të rrjetit NGN në kuadër të cilit është i nëdërlidhur rrjeti mobil dhe rrjeti PSTN/ISDN.




Figure 15. Organizimi i arkitekturës së rrjetit PSTN, IP (NGN) dhe mobil të Kosovës [10].

Rrjeti i Qasjes, Rrjeti Qendror, SoftSwitch, OSP, Sistemet Menaxhuese-Mirembajtjes, Shërbimi orientimi i thirrjes (Call Forwarding), me (Unconditional), abonenti i nxënë, shpallja fikse (Fixed Announcement), [8].

Shërbimet e prezentuara: CLIP, CLIR, COLR, COLP, CLNP, CLNR.
Afishimi i thirrjes: OCB, ICS (lista bardh e zi),

Bartësi në shkuarje (Outgoing call barring): konferenca 3 palëshe, transferimi i thirrjes, bajtja e thirrjes (Call hold, Call waiting), thirrjet emergjente (Emergency Calls). Në figuren e mëposhtme kemi të dhëna rrjetin optik dhe radio rele i cili shërben si shtyllë kurrizore për lidhjen e të gjitha centraleve skajore LS (llite spane) me soft switch në qendër-Prishtinë [10].

Rrjeti ekzistues SDH përbëhet nga dy unaza, dy nga të cilat lidhin Prishtinën, Mitrovicën, Pejën, Gjakovën, Prizrenin, Ferizajin dhe Gjilanin ndërsa tjetra shtrihet në drejtimin Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Fushëkosovë. Këto dy unaza janë të lidhura në Prishtinë ndërsa daljet në komunikacionin tranzit përfshijnë Prishtinë, Podujev – Nish e orientuar drejt Serbisë, e dyta Prishtinë, Hani Elezit, Shkup dhe e treta Prishtinë-Prizren- Tiran dhe magjistralja e Adriatikut




Figure 16. Principi i organizimit të rrjetit optik të transportit të Kosovës [7].

Në total, janë katër unaza STM-16, dy unaza STM-4 dhe disa unaza lidhëse STM-1. Sipas të distanca gjeografike distanca maksimale midis njëjeve SDH është më pak se 50 kilometra, kështu që nuk ka nevojë për regjenerator [7].

Aktualisht, mesatarja e ngarkesës në shtyllën e rrjetit kombëtare është rreth 60% për unazat STM-16, dhe rreth 65% për unazat STM-4. Kapaciteti tjetër i mbetur i lirë në këto unaza nuk mund të na sigurojë një garancë 100% për kërkesat e parashikuara për një rritje të kënaqshme në të ardhmen e afërt [10].

Rrjeti ekzistues gjithashtu kryen edhe shërbime të internetit, të te dhënave, Linjave të huazura me shpejtësi të ndryshme, dhe mund të transmetojë një shumëllojshmëri të jo-të zerit si ato multimediale dhe video konferencave.




Figure 17. Lidhjet kryesore transportuese në rrjetin e telefonis fikse dhe mobile në Kosovës [10].

5.3.2 Trendet në rrjetet e transportit – krijimi i një rrjeti fleksibil me shumë –shërbime

Rrjeti Metro në një të ardhme të afërt do të vazhdoj të përdoret si rrugë për transmetimin e shumë protokolleve të transmetimit, ndërsa rrjetet optike të transportit duhet të bartin ato pakete në mënyrë fleksibile dhe me efikasitet maksimal.

Futja e multiplexerve funksionale optik për-nderlidhje (lidhja opticalcross-connect) në skajin e një rrjeti optik ofron kapacitet të shkallëzuar dhe gjersi te brezit (bandwidth) të lëshimit fleksibël. Trafikut që hyn në rrjetin optik rigrupohen (grooming) për të pasur efikasitetin maksimal.

Multiplexerët optik periferik në të vërtetë do të luajë rolin e portave kryesore optike (gateway) të cilat bëjnë përpunimin e komunikacionit elektrik dhe optik –si p.sh IP, Ethernet, ATM dhe SDH – me qrast bëjnë konvertimet dhe kombinimet në sinjale optike për transport të mëtejshëm. Ata do të lejojë përdorimin e migrimeve teknologjike (legacy), si pjesë e konvergimit për infrastrukturate rrjetave te gjeneratave 3G ose 4G me shum-shërbime. Multiplexerët periferik optik do të ndërtohet në teknologjin SDH, që nënkupton se do të jetë e mundur për të menaxhuar me pjesë të vogla të brezit të lëshimit (Bandwidth), nga 50-150Mbit / s. Meqenëse më e rëndësishme ne këtë rast për të arritur scalability, multiplexerët fundor janë të dizajnuara për të trajtuar pothuajse të gjithë e rritjet e pritshme të trafikut [10][11].

5.3.3 Rrjeti NGN, ISDN dhe mobil i telekomit të Kosovës

Telekomi i Kosovës është operatori udhëheqës i telekomunikacionit në fushën e shërbimeve të ofruar brezit ngusht (narrowband) (PSTN / NGN), brezit gjere, mobil dhe të televizionit. Rrjeti mobil, fiks dhe transmetimit jan boshti kurrizor i cili shërben për shkëmbimin e informacioneve të zërit, të dhënave dhe sinjalit televiziv [8].




Figure 18. Struktura e rrjetit NGN [7].

Rrjeti telekomunit si mund të shihet më poshtë ka tri shtresa. Në krye të strukturës është nyja A ndërkombëtare / transit (IE / TE), te vendosura në Prishtinë, pastaj shtresa e dytë në hierarkinë përfshirëse të qyteteve kryesore të Kosovës si Peja , Ferizaj, Mitrovica, Gjakova, Gjlani, Prizereni, te perbere nga LS (Lite Spanat 1540, Alcateli), shtresa e tretë përfshin rajone të niveleve më të ulëta hierarkike.

5.4 Ndërlidhja e një telefoni të rrjetit fiks me kompleksin mobil të Vala

5.4.1 Administrimi i lëvizjes dhe përcaktimi i vendndodhjes së abonentit (Pagingu)

Meqenëse MSC një vetëm zonën e vendndodhjes të caktuar në të cilën gjendej për herë të fundit, atëher qeliza bartëse do të duhej të përcaktoj administrimin e lëvizjes së abonentit dhe do të përcaktoj vendndodhjen e abonentit. Prandaj MSC ngacmon të gjithë BSC-të për të shërbyer këto zona të vendndodhjes dhe për të kërkuar mesazhet nga qelizat. Kjo procedurë quhet Paging. Gjatë autenticitetit VLR dërgon RAND deri te MS. SIM kartela e pranon këtë informatë për llogaritje të SRES-it, të cilën e dërgon prapa deri te VLR për krahasim.

MSC-ja për celulë të caktuar siguron përgjigjenë e pagingut e cila varet nga BSC-ja deri te MSC. Pas regjenerimit të autentikimit dhe krijimit të TMSI të ri nga VLR-i kërkesa për thirrje nga MS është e kompletuar. Meqenëse MSC-ja një vetëm vendvendndodhjen e fundit të celulës në të cilën ndodhej MS, atëher do të duhej së pari të caktojmë celulën e vendndodhjes. Pasi që MSC-ja shërben të gjithë BSC-të , vendndodhjea e veçant do të kërkohej në të gjitha qelizat e kësaj zone. Kjo procedurë quhet Paging [10].




Figure 19. Mënyra për përcaktimit të vendndodhjes së një abonentit [11].

Forma tjetër e komunikimeve është komunikimet mes abonentit mobil dhe rrjetit inteligjent nëpërmjet të MOC e dhënë në fig.20.




Figure 20. Forma e komunikimit të abonentit mobil me rrjetin inteligjent pa ndërmjetime të sportelistës. [8]

Nëse caktimi i abonentit është i suksesshëm, MSC-ja bën lidhjen e kanalit të komunikimit deri te BSC-ja dhe abonentin IN. Regjistri HLR nuk është i involvuar në qështjenë e kërkimit të origjinës së thirrjes së mobilin [7].




Figure 21. Përcaktimi i vendndodhjes së abonentit dhe emitimi i TMSI dhe kërkesës së “Pagingut” nga MS dhe shtruarja e kërkesës për mbushje elektronike [11].

6. REZULTATET

6.1 Rezultati A

Në figuren e mëposhtme kam paraqitur rastin e ndërlidhjes mes një abonenti fikse deri te një abonent mobil. Principi i krijimit të lidhjes të abonentit mobil MTC i cili do të kërkonte një lidhje të kanalit të komunikimit. Regjistri VLR bën caktimin e autentimit, krijon TSMI-në e re dhe cakton kushtet për të cilat abonenti është i autorizuar të plotësojë shërbimet.

Raste shumë të rëndësishme mundë të paraqiten MTC (Mobile termination call) e cila merret me komunikimin e abonentëve nga rrjeti PSTN në rrjetin PLMN të cilën do ta parashtroj me paraqitje të komunikimeve me blloqe si në fig 22.




Figure 22. Principi i krijimit të lidhjes së sportelistes nga Posta me rrjetin inteligjent të operatorit mobil [11].

6.2 Rezultati B

Rrjeti inteligjent bënë analizën për kodin e rezervuar të mjeteve financiare të cilat i abonon pala dhe ndërlidhet me qendrën e mesazheve, ashtu që inicion procedurën për njoftim të palës se është përfunduar transaksioni financiar dhe njëkohësisht, nëpërmjet rrjetit inteligjent të MSC-së, GMSC-së, Nyjës A ose Nyjës B, rrjetit SDH, NGN-it, njofton abonentin duke e regjistruar në server transaksionin financiar së bashku me shumën e rimbushjes. Në anën tjetër SMSC-ja pas gjenerimit të informacionit, fillon procedurën e njoftimit të abonentit në rrugë drejt MSC-së,

SDH-së, BSC-së, lidhjes radio rele, BTS-it, pejjingut, deri te stacioni mobil i cili merr mesazhin e afishuar në ekran për vlerën e abonimit dhe kohëzgjatjen e vazhdimit të përdorimit të telefonit celular. Regjistri HLR nuk është i involvuar në këtë qështje.

Në të njëjtën mënyrë kryhet edhe transaksioni financiar nëpërmjet të kartelës grrithëse me ndryshim se rrolin e sportelistes e luan vet abonuesi i cili nëpërmjet të telefonit mobil komunikon me qendrën e rrjetit inteligjent dhe se këtu nuk futet në kombinim fare rrjeti fiks.

Nderlidhja mes dy rrjeteve fikse dhe mobile, siq shifet nga figura e mëposhtëme realizohet nga dy blloqet funksionale nga ana e telefonisë fikse Node A, B 7750 dhe GMSC e rrjetit mobil PLMN nëpërmjet sistemit transmetues SDH e cila fizikisht paraqet unaza e kabllit optik që ndryshe quhet Rrjeti qëndror i Kosovës.




Figure 23. Principi i ndërlidhjes të shërbimeve nga rrjeti telekomunikues fiks me rrjetin mobil [7].

7. DISKUTIME DHE PERFUNDIME

Aplikacionet e domosdoshme si zëri, të dhënat dhe videosinjali, janë kthyer si sfidë dhe nevojë për ofruesit dhe marrësit e shërbimeve të telekomunikacionit. Alcatel i është përgjigjur këtyre sfidave duke ofruar shërbime nëpërmjet shërbimeve Ethernet me bazë të biznesit, të tilla siq janë shërbimet virtuale private LAN (VPLS) dhe linjë virtuale me qira.

Këto shërbime i mundësojnë konsumatorëve ne rritjen e shërbimeve të biznesit dhe reduktimin e kostove, falë përfitimeve operacionale të Ethernet dhe cilësinë e parashikueshme të shërbimit (QoS). Në treg tani është duke lulzuar shërbimi i ri triple-play (shërbimi terfist) nëpërmjet Ethernetit i cili bënë grumbullimin e shërbimeve të trefishtë. Ky rrjet për të plotësuar këto kërkesa të grupuara duhet të jetë i optimizuar për zërin, video sinjalin me shpejtësi të lartë të shërbimeve të internetit, dhe mbi të gjitha ajo duhet të jetë jashtëzakonisht i aftë për të mbështetur llojet e numrave të parapagues për shërbime të konsumit të orientuar.

Faktorët kryesorë kontribues në këtë projeksion pozitiv janë përmirësimet operacionale, efikasitetit dhe sigurim i shërbimeve të aktivizuara, të bazuara në menaxhimin dhe mbështetja e shërbimeve me të dhëna.

Këto mjete i lejojnë ofruesit të shërbimeve për të detektuar gabimet dhe ofrimin e shërbimeve të shpejta, me një perspektivë end to end. Shërbimet Ethernet mund të bartin informata në distanca të largëta nga qendra e operacionale pa e ndërruar interfejsin fizik të rrjetit. Shërbimet nga 1 Mb / s deri 100 MB / s, ose prej 100 Mb / s deri në 1 GB / s mund të ofrohen pa ndryshuar ndërfaqen fizike me telefonin mobile të gjeneratës 4 G. Ky fleksibilitet mundëson ofruesit e shërbimeve për të ofruar klientëve shërbime sipas kërkesave të tyre.

8. REFERENCAT:

- [1] DIRECTIVE 2002/21/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on a common regulatory framework for electronic communications networks and services (Framework Directive), March 2002
- [2] Mobile messaging technologies and services, *Gwenaël Le Bodic*, John Wiley & Sons, Ltd 2005
- [3] Pyramid Research, *Key Trends in Central & Eastern Europe Fixed Communications*, December 2002
- [4] Electronic Communications Committee (ECC), *Application of the new EU Regulatory Framework to IP telephony*, Mart 2002
- [5] Black, U . Data Link Protokolls. NJ, 2009
- [6] Bradner, S., and Mankin, A. Ipng: Internet Protokoll Next Generation
- [7] Xhokli, M. (2004) “Projektimi i arkitekturës së rrjetave GSM dhe UMTS“ Tema magjistraturës. Universiteti i Prishtinës, 2004
- [8] Ramjee Prasad, Werner Mohr, Walter Konhauser, “Third Generation Mobile Communication Systems”. Boston. London, 2010
- [9] William Webb, *The future of Wireless Communications*, Artech House, Boston 2008
- [10] Projekti i migrimëve teknologjike të telefonisë fikse nga PSTN në NGN, Prishtinë 2005
- [11] Projekti i migrimëve teknologjike të telefonisë mobile GSM 2 në GSM 2.7 Alkatel 2008